



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 06 prill 2023, në mbledhjen e XI-të (njëmbëdhjetë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 13:25.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Naim Çunaku; Qëndrim Softolli; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Drita Pajaziti; Sebastina Vokri; Bashkim Syla; dhe Mrika Thaçi) bashkëngjitur lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje i pranishëm ishte edhe Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA.

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar mirëseardhje, konstatoi kuorumin, ndër të tjera theksoi, thirrja dhe materiali i kësaj mbledhje ju është dërguar me kohë edhe pse zyra përkatëse ka pas probleme për dërgimin e materialit, dhe atë në e-maillet private të një numri të madh të anëtarëve të Kuvendit dhe në këtë rast edhe të anëtarëve të KPF-së, kështu që i njëjti material është dashur të dërgohet dhe ridërgohet në pjesë-pjesë dhe përmes më shumë se 1 e-mail, por që në fund kam kërkuar që të paktën rendi i ditës së kësaj mbledhje të KPF-së t'ju dërgohet sepse pikat dhe materiali tjetër është i njëjtë me atë të Kuvendit.

Pra a jeni që të vazhdohet të punohet me këtë rend të ditës.

Njëzëri miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit të dërguar për këtë mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa e mbajtur më 30 janar 2023

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime, miratohet Procesverbali i KPF-ës nga mbledhja e datës 30.01.2023

2. Propozim Plani i Punës së Kuvendit të Komunë për vitin 2023 - Raporti nga diskutimet publike

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, dihet se për këtë Plan është formuar komision i cili ka punuar dhe ka sjellë këtë draft Plan të punës së Kuvendit për vitin 2023. Për vonesën e sjelljes së këtij drafti janë dy arsye përse nuk është sjellë në mbledhjen e parë të këtij viti, pra pas konsultimit publik nga Ministria është kërkuar të publikohet edhe në gjuhën serbe, për çka është shtyrë edhe një muaj, pastaj në muajin shkurt dhe mars kemi pasur dy

mbledhje të jashtëzakonshme në të cilat nuk ka mund të hyjë për shqyrtim në Kuvend, kështu që është shtyrë për këtë mbledhje për çka ju kërkoj falje sepse ky Plan është dashur të shqyrtohet dhe miratohet në mbledhjen e janarit të këtij viti.

Ky draft i planit të punës është hartuar nga Komisioni përkatës i përbërë nga anëtar të Kuvendit dhe nga Ekzekutivi i Kuvendit por edhe në bashkëpunim me drejtorët e Drejtorive të cilët i kanë propozuar pika e tyre të cilat planifikojnë t'i dërgojnë në Kuvend gjatë vitit 2023, ndërsa sa i'u përmbahen këtij planifikimi është përgjegjësi e tyre. Pra kjo ishte një hyrje për këtë pikë të rendit të ditës, ndërsa e hapi debatin.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, jemi në muajin prill të këtij viti dhe tani mbahet seanca e parë e rregullore e Kuvendit për këtë vit.

Kryesuesi i Kuvendit – Komitetit, sqaron se është për këtë vite është seanca e dytë e rregullt.

z.Qëndrim Softolli, vazhdoi, pra sjellët draft Planin i punës së Kuvendit në muajin e katërt të këtij viti kurse deri tani kemi mbajtur seanca dhe asnjë pikë e paraparë për muajt shkurt, mars dhe prill e që ka mundësi që në këtë muaj edhe ndonjë mbledhje sepse jemi në fillim të muajit, dhe sipas planit të punës as 20% nuk i është përmbajtur planit të punës. Në muajin mars është paraparë raporti financiar për vitin 2022, raporti financiar tremujor janar-mars, dhe nuk e kemi asnjërin. Planin e punës unë e shohë “sa për sy e faqe” vetëm sa të jetë një dokument në letër sepse nuk i përmbahet as ekzekutivi i Kuvendit e madje as ti (i drejtohet Kryesuesit të Kuvendit), pra që nuk po e shohë shumë seriozë këtë dokument dhe këtë qasje, kështu që vazhdojeni ashtu sikurse keni filluar.

z.Haki Rudari, theksoi, draft plani vjetori i punës së Kuvendit natyrisht se është obligim ligjor, por në të njëjtën kohë edhe lehtëson punën e Kuvendit duke i'u ofruar anëtarëve të Kuvendit dhe natyrisht në bazë të planit pastaj kemi edhe një pasqyrë se si do t'i kemi mbledhjet në vazhdimësi.

I bashkëngjitem asaj që e potencoj Kryesuesi se ky plan është paksa i vonuar dhe këtë duhet ta pranojmë si të vërtetë ngase sjellja e këtij plani është vonuar paksa sepse është dashur të miratohet më herët dhe për këtë pajtohem, megjithatë janë thirr disa mbledhje gjatë këtij viti ku dy prej tyre janë thirr të jashtëzakonshme dhe në mbledhje të tilla jemi në dijeni se nga aspekti ligjor nuk mund të propozojmë pika shtesë në rend të ditës e që mëno se kjo ka qenë një element që e ka pamundësuar, por edhe njëherë e potencoj se sjellja e planit është paksa e vonuar.

Realizimi i planit të punës natyrisht se kërkon një bashkërendim dhe bashkëpunim mes Ekzekutivit dhe anëtarëve të Kuvendit dhe në të njëjtë kohë pastaj kemi për muaj takimet / mbledhjet dhe pikat e rendit të ditës të cilat në një mënyrë edhe mund të ndryshojnë por jo në masë të madhe, qoftë data qoftë pikat e rendit të ditës, pra thjeshtë ky plan duhet të njihet dhe që duhet ta respektojmë të gjithë për arsye se është obligim ligjor sipas Ligjit për vetëqeverisje lokale dhe Rregullores së punës së Kuvendit dhe dispozita të tjera, prandaj ne Grupi nga radhët e LVV-së e përkrahim këtë draft plan të punës së Kuvendit për vitin 2023 dhe natyrisht nëse kemi ndonjë propozim shtesë nesër në mbledhjen e Kuvendit mund ta paraqesim, por që në parim e përkrahim.

z.Bashkim Sylja, theksoi, sa i përkatitjes së këtij draft plani, në komisionin përkatës kanë qenë të përfshira të gjitha subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend, kështu që jam për miratimin e këtij plani të punës, mirëpo sa i përket realizimit të tij të gjithë jemi në dijeni se ka vonesa, sidomos këta tre muajt e parë të vitit, kështu që është mirë që Ekzekutivi i Komunës në muaj e ardhshëm të shohin se cilat pika të planifikuara të rendit të ditës janë më të rëndësishme dhe t'i përfshijë në mbledhjet e ardhshme.

Sa i përket sjelljes së këtij dokumenti, nuk diskutohet se jemi paksa me vonesë, por pavarësisht kësaj e mbështesim për shqyrtim në Kuvend.

z.Naim Çunaku, theksoi, vetë arsyetimi për vonesën e këtij plani dhe kur e kemi parasysh që hartimi i planit të punës së Kuvendit fillohet me një parathënie e cila parasheh anën obligative e që edhe kolegu parafolës z.Haki Rudari e përmendi anën ligjore, Statutare dhe Rregulloren e punës së Kuvendit, kjo më bënë të shpërfaq një gjë që vërtetë Rregullorja e punës së Kuvendit e parasheh se si duhet të ndërtohet dhe

çka duhet të përmbaj një plan i punës gjë për të cilën nuk po dëshiroj të zgjas me nene dhe paragrafë e ndoshta i cekim në mbledhjen e Kuvendit, mirëpo vetë faktin që Kryesuesi i Kuvendit e arsyetoj duke cekur se nuk e kemi pas në dy gjuhësi, lë të kuptohet se sa jemi të përkushtuar për dokumente zyrtare të Komunës, sa jemi të përkushtuar për një plan të mirëfilltë që duhet të jetë në harmoni me të gjitha aktet normative pozitive që janë në fuqi, dhe të mos harrojmë se kemi një ligj, një udhëzim administrativ, kemi një rregullore për përdorimin e gjuhëve zyrtare në Kosovë.

Sigurisht se ndoshta nuk na vije mirë, por nuk e di dhe po hamendësoj duke besuar se sigurisht që Kryesuesi i Kuvendit por edhe znj. Mrika Thaqi janë në dijeni që kur kemi pasë atë Rregullore shumë më herët, na është kthyer me arsyetimin se nuk është edhe me shkronja çirilicë. Pra Rregullorja dhe ligjet në fuqi janë ashtu dhe nuk mund të ketë sot arsyetim që nuk është bërë duke thënë që nuk kemi qenë në dijeni, ndërsa sa i përket vonesë së këtij plani është një anë formale që po kërkohet me akte juridike që janë në fuqi dhe një plan i mirëfilltë pune i Kuvendit do të duhej ta luante rolin për çka bëhet një plan pune dhe do të duhej t'i paraprinte një pune të suksesshme të Kuvendit, andaj me vet faktin që ne këtë e miratojmë në muajin prill do të thotë se ne shkojmë prapa zhvillimeve, kurse plani është udhërrëfyes por jo ndjekës, mirëpo jemi këtu ku jemi, po shkon puna ashtu siç po shkon, po gjenden persona të cilët po mendojnë se duhet të përkrahet pavarësisht shkeljeve, vonesave e të tjerave ngase çfarë do qoftë ai e ka bërë dikush dhe i njëjti duhet të përkrahet.

Sa i përket asaj që e potencoj kolegu z. Bashkim Syla që të gjitha subjektet politike kanë pasë përfaqësuesit e tyre në Komision për përgatitjen e planit të punës, nuk është ashtu sepse LDK nuk ka pasë përfaqësues në hartimin e planit të punës dhe për këtë nuk dëshiroj të kthehem në retrospektiv se si ka ndodh sepse jam në dijeni krejt, por në atë mbledhje kur është vendos për anëtarët e Komisionit për hartimin e planit të punës, Grupi i LDK-së nuk ka qenë prezentë në sallë, e vërteta është se është lënë një vend i zbrazët e që LDK nuk ka dërguar përfaqësuesin e vet fare me arsyetimin se dihet çfarë po bëhet me planin e punës, dihet ku ka rënë Kuvendi e që ka dështuar krejt nga ajo që është i përcaktuar si mision i Kuvendit dhe nuk kemi dashtë të marrim përgjegjësi për atë, por si do që të jetë është një përmbushje ligjore, ju përgëzoj për këtë edhe pse me vonesë dhe mund të vazhdojmë.

z. Bashkim Syla, theksoi, sa për korrektësi unë tash po e di që përfaqësuesi i LDK-së nuk ka marrë pjesë në hartimin e këtij planit, por jam në dijeni se është dhënë hapësirë për të gjitha grupimet politike për të marrë pjesë në përgatitjen dhe hartimin e planit të punës ndërsa a marrin apo jo pjesë është problem i tyre, kështu që nuk e kam pas atë informacion që nuk ka marrë pjesë përfaqësuesi i LDK-së dhe as nuk e potencova me asnjë qëllim por veç si informatë që ky plan është sjellë si konsensus i të gjitha subjekteve dhe akterëve politik të këtij Kuvendi që kanë qenë pjesë e Komisionit, kështu që sa i përket çështjeve tjera ne mund të diskutojmë sa të doni por kjo ishte ajo që unë e potencova.

z. Naim Çunaku, theksoi, edhe njëherë kërkoj që mos të kuptohet si polemik por vetëm sa për sqarim, pra i nderuar z. Bashkim Syla, nuk e kisha për polemika sepse fundja pse nuk kemi pas përfaqësues në atë Komision edhe pse kemi pasë një vend në kuadër të Komisionit përkatës edhe pse ai vendim nuk e ka kaluar anën formale sepse Kuvendi është dashtë të merr vendim për emrin e anëtarit të LDK-së, kjo nuk është bërë dhe ne nuk kemi dashtë në asnjë formë që ta cenojmë legjitimitetin e hartimit të planit, për ata edhe nuk kemi marrë pjesë. Dhe duke pasë parasysh që vazhdimisht propozimet e Grupit të LDK-së anashkalohen, kjo si strategji e zgjedhur e atyre që qeverisin, por që atë boshllëkun e pjesëmarrjes së përfaqësuesit të LDK-së e kam parë edhe në diskutimet publike, por edhe ai Komision është mbush me anëtarë të Ekzekutivit të Komunës e që për mua dhe për demokracinë gjëja më e dhimbshme është që ekzekutivi ta përgatit planin e punës së legjislativit, mirëpo e keni zgjedhë këtë formë, vetëm vazhdojeni.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, mund t'ju informoj se para çdo takimi që ka pasë Komisioni për hartimin e planit të punës së Kuvendit për vitin 2023, shefi i Grupit të LDK-së z. Valon Demolli është ftuar dhe i njëjti çdo herë ka potencuar se do ta dërgon një anëtarë të Grupit të LDK-së në këtë Komision, por që nuk

është dërguar asnjëherë e që është e drejtë e tyre por që asnjëherë nuk është arsyetuar mos dërgimi, pra njëherë më ka propozuar anëtarin z.Arjant Topanica, herën tjetër z.Qëndrim Softollin, kështu që kushdo qoftë për mua do të ishte i mirëseardhur në Komision.

z.Naim Çunaku, theksoi, duhet të kemi një diçka parasysh, ne nuk jemi grup i pleqnarëve këtu, punën tonë e rregullojnë aktet normative që janë në fuqi. Me vetë faktin që kur është themeluar Komisioni në fjalë prej subjekteve të ndryshme, LDK nuk e ka pasë përfaqësuesin e vet në atë Komision dhe nuk kemi dashtë të involvohemi më në këtë punë, ndërsa e gjithë ajo që u tha që e kam thirr z.Valon Demollin, jo është propozuar ai apo ky anëtar, është qëndrim i ynë që ne nuk kemi dashtë të involvohemi në atë çështje dhe nuk dëshirojmë të marrim pjesë në hartimin e një pune ku Kuvendit të Komunës i'a përgatit Ekzekutivi planin e punës.

z.Haki Rudari, theksoi, natyrisht se debatet e ndryshme të bëjnë edhe të marrësh fjalën dhe të ndrysh në disa çështje. Unë e dëgjova kolegun nga radhët e LDK-së kur e potencoj se nuk kemi dashtë të jemi pjesë e këtij Komisioni, e që është e drejtë e tyre, madje edhe unë e kam të drejtën të mos marrë pjesë në ndonjë mbledhje të ndonjë komisioni, mirëpo Kuvendi i Komunës ka themeluar një Komision me anëtar të partive të ndryshme politike dhe në atë Komision ka pasë vend edhe për përfaqësuesin e LDK-së.

Unë këtu po e shoh se është mbajtur një debat me qytetarë dhe është mirë që Kryesuesi i Kuvendit të na njoftoj se a ka qenë i ftuar edhe ndonjë përfaqësues i LDK-së, dhe në rast se kanë qenë të ftuar dhe nuk kanë ardhur ajo është diçka tjetër, por nuk mund të thuhet se edhe na kanë ftuar edhe nuk dëshirojmë të marrim pjesë edhe nuk kanë të drejtë të jenë Ekzekutivi. Plani i punës hartohet në bashkëpunim dhe bashkërendim me Ekzekutivin e Komunës sepse nuk mund të anashkalohej Ekzekutivi i Komunës në çështje të tilla, nuk ka mundur as edhe atëherë ku ne kemi qenë në opozitë, e as nesër kur ndokush tjetër që do të jetë në pozitë, do të thotë hartimi i planit të punës bëhet në një bashkëpunim të ngushtë në mes përfaqësuesve të këshilltarëve nga partitë politike dhe natyrisht edhe përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës, prandaj po e them se përbërja ka qenë ashtu siç është e paraparë me ligj, kurse për që nuk kanë marrë pjesë përfaqësues të LDK unë sot po e di përse.

z.Naim Çunaku, theksoi, sqarimi që u kërkuar të bëhet nga Kryesuesi i Kuvendit se a i ka ftuar po jo përfaqësuesit e LDK-së, unë edhe në diskutimin paraprak e potencova se këtu nuk jemi në pleqëri këtu, a janë ftuar a jo, Kuvendi është organi ai i cili formon komisione, atë ditë kur është formuar ky Komision LDK nuk ka marrë pjesë në Kuvend dhe si rezultat i kësaj LDK nuk ka pasë anëtar në atë Komision të miratuar nga Kuvendi si tërësi, ndërsa sa i përket bashkëpunimit ndoshta doli keq ajo që e potencova Ekzekutivi i Komunës, por nuk ishte në kuptimin sikur ta kishim armik Ekzekutivin, mirëpo Ekzekutivi e ka të ndarë rolin e vet për çka, dhe Kuvendi e ka kompetencën e vet për çka. Andaj pa dashur të hyjë më në detaje sot sepse sigurisht se në seancën e Kuvendit do ta citojmë edhe Statutin edhe Rregulloren e punës së Kuvendit me nene të caktuara ku plani i punës së Kuvendit përgatitet mbi programin e punës së Ekzekutivit, por jo Ekzekutivi t'i bënë plan të punës Kuvendit të Komunës, pra i nderuar zotëri Rudari, plani i punës së Kuvendit përgatitet mbi programin e punës së Ekzekutivit e që ne fatkeqësisht program të punës së ekzekutivit vetëm mund ta imagjinojmë sepse nuk kemi pas asnjëherë.

z.Haki Rudari, theksoi, i nderuar Çunaku, plani i punës së Kuvendit miratohet, propozohet në atë Komision që e cakton, del apo që e nxjerrë Kuvendi i Komunës dhe në atë Komision përveç këshilltarëve komunal sipas ligjit janë të paraparë të jenë edhe përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës pastaj edhe nga Shoqëria civile, do të thotë që secili ka pasë të drejtë të propozon planin e punës, edhe ne si këshilltar qoftë nga pozita qoftë nga opozita kemi pas të drejtë të propozojmë pika, prandaj nuk mund ta përgatitim një plan të punës duke anashkaluar Ekzekutivin e Komunës sepse kjo është me ligj dhe këtë ia garanton ligji që Ekzekutivi duhet të jetë pjesë e hartimit të planit të punës. Pastaj askush nuk mund të na e ndaloj neve këshilltarëve të Kuvendit që të japim propozimet tona, qoftë në nivel personal qoftë në nivel të grupeve, prandaj po dëshiroj të them se Komisioni në fjalë ka dal nga Kuvendi i Komunës ashtu sikurse e

parashih ligji në bashkëpunim me Ekzekutivin e Komunës, kurse pajtohemi me atë që plani është paksa i vonuar mirëpo këtu ku jemi na duhet të vazhdojmë tutje.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk dëshiroj të vazhdoj tutje sepse nuk jam i gatshëm për lojë fjalësh.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, ne i kemi njoftuar Grupin e LDK-së dhe arsyeja e vetme e mospjesëmarrjes ka qenë ajo që e potencoj z.Naim Çunaku që nuk është votuar emri i përfaqësuesit të LDK, ndërsa tani ne askush askënd nuk mund ta obligoj që të marr pjesë. Grupi i LDK e ka pas vendin me një anëtar të tyre në Komisionin në fjalë sikurse e kanë pasë edhe përfaqësuesit e tjera subjekteve, pastaj përfaqësuesit e Ekzekutivit të Komunës dhe në atë mënyrë është punuar ku drejtorët e Drejtorive i kanë paraqitur pikat që planifikojnë t'i diskutojnë dhe shqyrtojnë në Kuvend, pastaj është mbajtur edhe një diskutim publik dhe është ardh në përfundim që ky plan i punës është komplet kështu çfarë është, kurse sa dhe si realizohet ne nuk mund të parashikojmë por qo të shihet gjatë vitit.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk doja të hyj në këto çështje sepse janë gjëra që të gjithë i dimë, por po duam t'i themi me fjalë tjera. Në atë mbledhje kur është vendos të themelohet Komisioni në fjalë, ka qenë edhe formimi i Komisionit për procesin e këshillave të fshatrave, vendbanimeve dhe lagjeve urbane dhe në atë Komision nuk i'u është lënë vend, ndërsa në Komisionin për planin e punës së Kuvendit i është lënë vendi dhe atë pa emër dhe është votuar ai komision pa emër të përfaqësuesit të LDK-së, do të thotë në një formë mund të themi se duam apo jo nuk është legal sepse nuk ka votuar Kuvendi për ndonjë emër, pra kjo është e vërteta, ndërsa tani si do ta quajmë ne, me faj tonin a pa faj tonin, me të drejtën tonë ose pa të drejtën tonë, ne vendosim për Grupin që përfaqësojmë, ndërsa sa i përket asaj që po thuhet në lidhje me Ekzekutivin e Komunës edhe njëherë po e them se Ekzekutivi i Komunës paraqet para Kuvendit të Komunës planin e punës së vet, dhe mbi atë bazë pastaj Kuvendi mendon se kur është më e favorshme për Kuvendin që në një formë drejtpërdrejtë e monitorojnë atë plan të punës së Ekzekutivit.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, konsideroj se debati për këtë pikë përfundoj, andaj meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën unë e hedh në votim që kjo pikë e endit të ditës të rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Me 6 vota PËR, (të tjerët nuk morën pjesë në votim), i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim Propozimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2023, përfshirë edhe Raportin nga diskutimet publike sipas materialit përkatës të dërguar me thirrjen e mbledhjes.

3. Propozim Vendimi për vënie në diskutim publik të Draft Planit të Integritetit për Komunën e Podujevës 2023-2027.

z.Hilmi Hoxha, **Kryesuesi i Komitetit**, theksoi, nëse nuk gaboj diçka kjo pikë është sjellë nga Nënkryetarja e Komunës, por që ajo nuk ka pas mundësi sot të jetë prezentë në këtë mbledhje, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën.

z.Naim Çunaku, theksoi, është e vërtetë që një plan të tillë e kemi obligim që ta kemi si Komunë, mirëpo qëndrimin që e kemi pasë në një seancë të mëparshme të KPF që ai që e sponsorizon një pikë të rendit të ditës apo më mirë të themi se kemi pas një dakordim që çdo propozim që vije në mbledhjen e KPF-së duhet që sponsorizuesi ta arsyetoj në atë para anëtarëve të KPF-së, kurse sot po shihet se si po arsyetohet, si të dëshironi bëjani.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, ne Grupi i LVV-së e përkrahim që ky propozim vendim të rekomandohet për shqyrtim në mbledhjen e Kuvendit për ditën e nesërme. Sugjerimet dhe propozimet tona sigurisht se do t'i japim nesër në mbledhjen e Kuvendit.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, **për këtë propozim vendim kemi të bëjmë vetëm që t'ia japim pëlqimin për diskutim publik.**

z.Naim Çunaku, theksoi, ne mund ta kalojmë por del që “po i hani fjalët”

Kryesuesi i Komitetit, vazhdoi, na keni mësuar më herët “me i hangër fjalët e tash po i hajmë edhe ne”. Pushteti i mëhershëm na ka mësuar.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk është pushteti i mëhershëm këtu, por ne të tanishmit kemi marrë qëndrim që e potencova, është kjo përbërje e KPF-së, jo një tjetër, andaj nuk e di si mund të thuash shembull, unë i kam duart e zhytura sepse i ka zhytur edhe ai përpara.

Kryesuesi i Komitetit, vazhdoi, sot e kemi ndërruar edhe kohën e mbajtjes së mbledhjes, arsyeja është sepse jemi edhe në muajin e ramazan, pra ka qenë edhe kërkesë e shumë anëtarëve të KPF-së që kjo mbledhje të mbahet pasdite, pra kjo ka qenë edhe arsyeja që nuk ju është përputhur termini që të jenë prezent në këtë mbledhje, mirëpo me siguri në mbledhjen e Kuvendit do të jetë prezent sponsorizuesi i kësaj pike dhe ato që kanë pas të thuhet në KPF do të thuhet edhe në Kuvend.

Atëherë meqë nuk ka të lajmëruar tjerë për të marrë fjalën, e hedhin në votim këtë propozim vendim sipas kësaj pike të rendit të ditës.

Me 5 vota PËR, asnjë votë KUNDËR, 1 votë të PËRMBAJTUR (të tjerët nuk morën pjesë në votim), rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim Propozim vendimi për vënie në diskutim publik të Draft Planit të Integritetit 2023-2027 për Komunën e Podujevës.

4. Propozim Programi trevjeçar i banimit 2023-2025

- Raporti nga diskutimi publik / Debatë Publikë lidhur me programin tre vjeçar të banimit 2023-2025.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, lidhur me këtë pikë të rendit të ditës besojeni se drejtoresha e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale si iniciuese e këtij dokumenti më ka njoftuar përmes telefonit se është në pushim mjekësorë dhe nuk ka pasë mundësi të vijë në këtë mbledhje por nesër në mbledhjen e Kuvendit do të bëjë përpjekje të jem prezentë dhe të bëjë sqarimet e nevojshme lidhur me këtë pikë të rendit të ditës. Pra kjo ishte kërkesë e drejtoreshës znj.Adelinë Stublla.

z.Naim Çunaku, në emër të grupit të LDK-së theksoi, e marrim parasysh kërkesën e drejtoreshës në fjalë dhe meqë na është drejtuar në këtë formë edhe ne e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim në mbledhjen e nesërme.

z.Haki Rudari, në emër të Grupit të LVV-së theksoi, ne e përkrahim Programin Trevjeçar të Banimit 2023-2025, natyrisht se e drejta e banimit është e garantuar me Kushtetutë dhe me Ligj dhe mendoj se në këtë drejtim vetëm e ka përkrahjen tonë.

z.Bashkim Sylja, në emër të Grupit të PDK-së theksoi, edhe ne e përkrahim këtë propozim vendim sepse edhe arsyetimi i drejtoreshës në fjalë ka qenë është me probleme shëndetësore, kështu që ne jemi për, që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Njëzëri, me 9 vota PËR, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim Propozim programi tre vjeçar i banimit 2023-2025, përfshirë edhe Raportin nga diskutimi / debati publik lidhur me programin tre vjeçar të banimit

5. Raporti i Punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2022.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, kemi këtë raport të Kryetarit të Komunës të cilin besoj se Kryetari e ka përgatitur dhe nesër në seancën e Kuvendit do ta prezantoj më konkretisht para anëtarëve të Kuvendit. Pra kemi të bëjmë me punën 1 vjeçare të Kryetarit kështu që do të kemi mundësi dhe kohë të diskutojmë dhe të informohemi lidhur me këtë çështje.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk e di ndoshta mund të bëhem i tepërt ta lexoj një nen për KPF-në, por sigurisht se e kemi lexuar të gjithë dhe nuk po e lexoj fare tani, mirëpo të paraqitet një raport, i kujtdo qoftë ai e që në këtë rast është i Kryetarit të Komunës, dhe të mos kemi kurrfarë materiali dhe të mos kemi kurrfarë plani gjegjësisht programi të punës të miratuar të Kryetarit të Komunës, pra cila është referenca, kujt t'i referohemi ne për punët e kryera apo mos kryera. Si mund të kemi një raport pa pasur asnjë material. Kolegu z.Bashkim Sylja nga vendi po më thotë se e kemi buxhetin e miratuar, unë e di këtë, por në rastin më të mirë të mundshëm plani/programi i punës është obligativ për Ekzekutivin që ta sjellë atë në Kuvend për miratim, pra atë duhet ta kishim, pastaj material tani diçka nuk kemi, atëherë në çka të referohemi ne, fundja atë e ceku kolegu zotëri Sylja, të paktën ta kishim raportin financiar deri më 31 mars që është obligative, kurse ne sot jemi në muajin prill dhe nuk e kemi atë, madje as raportin e auditimit të jashtëm që do të vije më vonë, e as raportin e auditorit të brendshëm.

Për të qenë e kompletuar një pasqyrë për të mund ta shohë një këshilltarë gjegjësisht një përfaqësues i qytetarëve që është deleguar këtu për ta monitoruar punën e Ekzekutivit të Komunës, të paktën do të duhej të kishte diçka në dorën e tij në mënyrë që ta konsultoj atë, ndërsa a kemi ne diçka të tillë jo, me mirëbesim mund të vazhdojmë edhe me këtë.

z.Bashkim Sylja, theksoi, nuk dëshiroj ta mbroj askënd këtu, as kryetarin e as askënd tjetër por vetëm po dëshiroj t'ia rikujtoj z.Naim Çunakut se në mandatin e kaluar për 3 vite Kryetari i Komunës nga radhët e LDK-së asnjë mbledhje nuk e ka mbajtur në Kuvendin e Komunën me neve si këshilltarë të Kuvendit e që për këtë sigurisht se janë në dijeni edhe isha anëtarët që edhe tani janë prezent këtu z.Qëndrim Softolli dhe znj.Mrika Thaçi, pra nuk ka pasë shanse të vije këtu dhe të paraqes raport për punë 1 vjeçare të tij, pra asnjë mbledhje nuk e ka mbajtur me neve, këtu është dallimi andaj edhe po dua të jem njerëzorë.

Sa i përket këtij raporti, pajtohem që do të duhej ta kishim më herët vetëm raportin financiar për vitin e kaluar, do të ishte gjithçka në rregull, përndryshe buxhetin e kemi të miratuar dhe në bazë të buxhetit raportohet dhe mund ta dimë çka është punuar dhe çka jo, mirëpo po ta kishim edhe raportin financiar për vitin 2022 do të ishte paksa më i përmbushur sepse do ta dinim çka punuar e çka jo, çka është përfunduar çka nuk është përfunduar, ndërsa sa i përket raportit që nesër e sjellë Kryetari unë jam i kënaqur me atë mundësi që anëtarët e Kuvendit kanë mundësi të kërkojnë llogari për vitin e kaluar, përderisa në mandatin e kaluar nuk kemi pas mundësi në asnjë seancë ta mbajmë me Kryetarin e Komunës, e lëre më të raportoj, kurse për 3 vite kanë qenë rreth 6 milion euro suficid dhe askush nuk ka dhënë llogari përveç disa ish drejtorëve dhe ish Nënkryetarit të Komunës për të cilin unë personalisht kam një falënderim sepse në çdo seancë ka qenë i pranishëm në mbledhje, mirëpo ish Kryetari nuk marrë pjesë në Kuvend për 3 vite me radhë, asnjë përgjegjësi para popullit dhe para asambleistëve nuk e ka mbajtur, asnjë pyetje nuk e ka pranuar, andaj për këtë e potencova se duhet të jemi paksa më njerëzor dhe të mirat dhe kritikën duhet t'ia japim secilit.

z.Naim Çunaku, theksoi, kjo forma duke theksuar se çka kanë bërë të tjerët në të kaluarën dhe tani po bëhet më mirë se ata, unë nuk e pranoj këtë. Të thirremi në praktikën që kanë ndodh në Kuvend, unë i besoj parafolësit z.Bashkim Sylja sepse ashtu ka qenë dhe nuk është raportuar, mirëpo meqë filluam me praktikën tona personale unë po e them një timen dhe të Kryesuesit të Kuvendit nëse memorien e ka të freskët, është në dijeni se një Kryetari të mëparshëm i cili ka qenë nga LDK, i'a kemi ndërprerë seancën deri sa e kemi detyruar ta sjellë raportin, apo deri është zotuar se do ta sjellë raportin e auditorit të

brendshëm, raportin financiar, pra rolin e opozitë bërjes e kemi bërë ashtu siç na e ka mundësuar ligji dhe atë po e bëjmë edhe sot, andaj nuk është diçka që po e bëjë dhe që po e përmendi për këtë Kryetar që është aktualisht dhe për mua Kryetari i Komunës nga dita që e ka dhënë betimin në Kuvend nuk është Kryetar partiak më por është Kryetar i të gjithë qytetarëve të Komunës, dhe fare nuk jam i ngarkuar prej nga vie, i cilit subjekt është, dhe po të ishte lehtë të bëhej dhe të ta mban këtë post edhe unë do të kandidoja për kryetar ndoshta, por nuk jam dhe është dikush tjetër të cilin natyrisht se e respektoj.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, ne e kemi konsultuar edhe me ligj dhe askund nuk kemi gjete se Kryetari është i obliguar ta dërgon materialin anëtarëve të Kuvendit, mirëpo Kryetari raporton në Kuvend për punën e planifikuar dhe premtuar në fushat se do ta bëjë, andaj unë besoj se Kryetari ka premtuar se për vitin 2022 do t'i bëjë këto apo ato punë, kurse nesër do ta shohim se a i ka kryer apo jo.

Sa i përket raportit për buxhetin, unë kam biseduar edhe me drejtorin e Drejtorisë përkatëse dhe nga ai jam njoftuar se nuk mund të raportoj sepse deri më tani nuk më janë sjellë informatat komplet prej Ministrisë përkatëse, kjo për arsye se ajo Drejtori është e lidhur direkt me Ministrinë e Financave, kështu që ai drejtor e ka lënë që brenda këtij muaji në mbledhjen e radhës ta sjellë raportin financiar, ndërsa se a është vonuar apo jo ai raport unë nuk kam përgjegjësi për punën e tij sepse ai i din dhe ai duhet t'iu përmbahet obligimeve dhe përgjegjësive që ka. Pra për këtë mbledhje, sipas tij nuk i ka pas gjitha dokumentacionet që është dashur ti ketë për raportim, kështu që ka mbet që në fund të muajit të mbahet edhe një mbledhje dhe të sjellët ai raport.

z.Haki Rudari, theksoi, raporti financiar për vitin paraprak dhe raporti i punës realisht janë dy gjëra të ndryshme dhe të kundërta njëra me tjetrën. Raporti financiar për vitin 2022 sigurisht se do të vie dhe kjo është çështje e drejtorit se kur do të vie, por sigurisht se do të vie. Ne tani kemi raportin e punës së Kryetarit për vitin 2022 dhe për këtë çështje e cekën edhe kolegët parafolës dhe po e them edhe unë se për herë të parë që nga viti 2013 prej që jam anëtar i Kuvendit për herë të parë nesër e kemi një raport të punës së Kryetarit të Komunës dhe çfarë do të thuhet në atë raport të punës sigurisht se do ta dëgjojmë nesër, por raporti i Punës së Kryetarit sigurisht paraqet projektet të kryera nga Drejtoritë e ndryshme, ndërsa raporti financiar është aspekti financiar i harxhimeve etj etj. Ne Grupi i këshilltarëve të LVV-së rekomandojmë që kjo pikë të kalon për seancën e nesërme të Kuvendit për diskutim.

z.Naim Çunaku, theksoi, ose unë nuk po di t shprehem ose nuk po kuptohem drejtë, në asnjë vend unë nuk e thash që është obligim ligjor për sjelljen e materialit të raportit të punës së Kryetarit, pra dua të jem përgjegjës vetëm për atë që e potencova. Ligjërisht Kryetari i Komunës është i obliguar dy herë brenda vitit të raportoj në Kuvend për punën e tij, pra këtë e thotë ligji, jo unë, ndërsa kur e përmenda raportin financiar për vitin e kaluar, e që kolegu parafolës e ceku se janë gjëra të kundërta, mos të lutem sepse këtë e kuptoj shumë mirë dhe nuk janë gjëra të kundërta por janë dy çështje të ndryshme, por jo të kundërta mes vete. Poenta ime ishte që për ta dëgjuar një raportim të dikujt unë duhet ta kem një material, qoftë planin e punës, qoftë programin e punës, qoftë raportin financiar dhe atë vetëm si pikë referente se çfarë është realizuar, pra këtë e thash unë, asgjë tjetër.

Tani po e lexoj, Komiteti për Politikë dhe Financa është përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha politikave, dokumenteve fiskale dhe financiare, planeve dhe iniciativave, duke përfshirë dokumentet e planifikimit strategjik, kornizën vjetore buxhetore dhe afatmesme, planin vjetor të prokurimit publik, rregulloren vjetore për tatimin, tarifat, pagesat, planin vjetor të punës të auditimit të brendshëm, buxhetin vjetor afatmesëm dhe çdo ndryshim gjatë vitit fiskal, për marrjen e raporteve nga Kryetari dhe dorëzimin e tyre para Komitetit për Politikë dhe Financa. U thirrët në atë se këtë nuk e kanë bërë të tjerët, ndërsa unë pyes a kemi pasë ndonjëherë këto gjëra për mbi 1 vit që jeni ju tani, të më tregoj dikush, unë jo kurse për ju nuk e di, ndoshta mund të thoni që po sikurse që Kryesuesi i Kuvendit e potenconte në një emision në TV Llapi që kemi pas raport, por e vërteta është që nuk kemi pasë, opinionin mund të manipulohet dhe çdo kush mund të luan me atë të vetën, por e vërteta është ndryshe, nuk kemi pasë.

Ndërsa për punën që e ka bërë LDK në 20 vitet e kaluara, kur do që dëshironi e thërrasim një seancë të Kuvendit dhe i “dënojmë”, por unë e di që ata nuk janë më në pushtet, ajo strukturë ka marrë një verdikt qytetarë dhe është shpërblyer ose dënuar për punën e vet, mirëpo nuk mund t’i kemi pikë reference gjërat e këqija, por duhet t’i marrim si pikë referente gjërat e mira.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, po shihet se tash ka gjëra pak më të mira, po vie Kryetari për herë të parë dhe do t’i duartrokitim.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk mund ta pranoj unë atë që e thoni sepse vitin e kaluar nuk kemi pasë asnjëherë raportin e Kryetarit, kurse i nderuar Kryesues i Kuvendit ty të kam dëgjuar në TV Llapi duke thënë se e kemi pasë dhe duke ngritur lartë disa letra.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, edhe unë jam ithtarë i asaj që të mos merremi shumë me të kaluarën, të drejtën jua them që të mundohemi të punojmë qysh është më së miri sepse e kemi obligim që qytetarët na e kanë dhënë, ndërsa sa i përket asaj që z.Naim Çunaku e potencoj unë e kam marrë një raport prej Ministrisë përkatëse në të cilin shkruhet se Kryetari i Komunës së Podujevës ka raportuar dy herë brenda vitit në Kuvendin e Komunës, edhe pse ndoshta Ministra e ka ngatërruar me raportin e Kryetari që ka bërë me qytetarë.

z.Naim Çunaku, theksoi, kjo që u cek do të thotë se edhe Ministria e falsifikuar dokumente, andaj mos ta hapim këtë temë tani ju lutem.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, sigurisht është ngatërruar grafikoni i debateve me qytetarë dhe raportimeve në Kuvendin e Komunës, pra diçka ka ndodh mirëpo të mos e debatojmë këtë çështje më shumë sepse po kalojmë në temë tjetër.

Me 6 vota PËR, (të tjerët nuk morën pjesë në votim), i rekomandohet Kuvendit për diskutim Raporti i punës së Kryetarit të Komunës për vitin 2022.

6. Propozim Plani i Punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi 2023

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, theksoi, edhe për këtë pikë të rendit të ditës materiali ju është dërguar me kohë, edhe pse tani nuk është ndokush prezent për ta prezantuar këtë propozim plan të punës së KKSB-së, mirëpo e hapim debatin edhe pse nuk e kemi ndonjë prej anëtarëve të KKSB-së që ta paraqet këtë propozim plan, përndryshe unë nuk jam anëtar i këtij Këshilli dhe nuk mund ta prezantoj këtë dokument.

z.Naim Çunaku, theksoi, as unë nuk jam anëtar i KKSB-së por me vet faktin që KKSB duhet ta sjellë planin dhe raportin në Kuvend, edhe ne jemi përgjegjës dhe asgjë nuk na behje më pak përgjegjës neve që nuk jemi anëtar përderisa ata na raportojnë neve si Kuvend si dhe me vet faktin që ne duhet të marrim miratimin e këtij plani do të thotë se ne jemi faktorë në përcaktimin e sigurisë sepse ne jemi këtu na intereson siguria e Komunës tonë, gjegjësisht e bashkësisë tonë.

E vërteta është se KKSB përbëhet ashtu siç e përcakton ligji dhe dihet kush është Kryesues i tij e që është Kryetari i Komunës. Kam dëgjuar dhe e kam konsultuar materialin e kësaj pike të rendit të ditës, dhe nëse shkojmë me logjikën dhe metodën kooperative ka diku më mirë dhe diku më keq, e sigurisht se gjejmë diku më keq se Komuna e Podujevës, por nuk dua dhe nuk e kam vullnet që Komunën time ta shoh me ato të këqijat por me ato të mirat.

Në bazë të raportit apo materialit përkatës, në vitin e kaluar janë mbajtur gjithsej 4 mbledhje të KKSB, e vërteta është që në ato materiale gjendja në Komunën tonë dita ditës është duke u rënduar dhe jemi dëshmitar të ngjarjeve që na kanë ndodh në qytet dhe në lokalitete të ndryshme, dhuna është shpeshuar, kurse dukuria më shqetësuese që më ka rastësisë ta lexojë është në sferën e arsimit, përdorimi dhe devijimi

nga rruga e nxënësve në kuptimin e konsumimit të lëndëve që dëmtojnë shëndetin dhe sigurinë e që janë narkotikë të ndryshëm. Besoj që pavarësisht që KKSB është komision, duhet të ngritët alarmi, jo pse jemi më së keqi si Komunë në këtë aspekt, por alarmi që ata janë fëmijët tanë dhe gjithsecili prej neve të mundohet të jap kontributin e vet në mënyrë që të kemi sa më pak të tillë.

Ajo që e kam parë si mangësi tek ai raport, jeni në dijeni se kur e kemi pasë raportin për vërshimet këtu jemi shtyrë dhe kemi përdorë fjalë të ndryshme e që ndoshta të gjithëve kur unë kam kërkuar më shumë se 1 vit që ta kemi një plan për emergjenca e që na është thënë se është një plan i vjetër dhe është duke u punuar një plan tjetër i ri, dhe tani paramendojeni ka qenë një plan i vjetër të cilin nuk e ka parë askush, por plan të ri nuk kemi. Fatkeqësisve natyrore nuk i'u dihet, ne në fakt kemi qenë të atakuar prej vërshimeve mirëpo nuk i dihet fuqisë së natyrës dhe të Zotit dhe nuk i dihet mund të kemi edhe raste tjera që mund të jetë e nevojshme të ketë intervenime urgjente, andaj një Komunë sikurse që është kjo e jona të mos ketë ende një plan për intervenime emergjente, më duket se nuk jemi në nivelin e kohës dhe në nivelin e duhur si duhet të jenë ata që kemi marrë besimin për t'i prirë qytetarëve.

z.Haki Rudari, theksoi, KKSB natyrisht se është formuar në bazë të ligjit dhe përveç Kryetarit të Komunës në përbërje janë edhe drejtorët e Drejtorive sipas pozitave përkatëse, nëse nuk gaboj 3-4 drejtor të Drejtorive, pastaj përfaqësues të Policisë, FSK-së, OJQ-ve, prandaj në këtë drejtim unë e them se do të ishte mirë të ishte prezent këtu ndokush nga këta anëtarët e këtij Këshilli për të raportuar, mirëpo pavarësisht kësaj ne Grupi i LVV-së e përkrahim që kjo pikë t'i rekomandohet Kuvendit për debat, megjithatë edhe një herë po e theksoj që KKSB formohet në bazë të ligjit dhe në përbërje janë disa drejtor të Drejtorive, OJQ, FSK, Polici, prandaj e them se ndokush nga këta është dashtë ta marrë përsipër dhe të vijë dh të raportoj dhe të kemi një informatë dhe që këtë propozim plan ta paraqet edhe këtu në KPF, përveç Kuvendit të Komunës që sigurisht se do ta paraqesin. Si do që të jetë ne e rekomandojmë për diskutim nesër në mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

z.Bashkim Syla, theksoi, KKSB është i krijuar brenda mandatit të qeverisjes dhe tani jemi duke diskutuar vetëm për planin e punës së Këshillit për vitin 2023, kështu që është mirë që çdo breng, çdo pakënaqësi dhe çdo shqetësim tonin ta paraqesim në debat. Unë pajtoj plotësisht me atë që e potencoj z.Naim Çunaku sa i përket lëndëve narkotike nëpër shkolla dhe ambiente shkollore, mirëpo ta shohim njëherë raportin e tyre dhe planin e tyre se çfarë kanë paraparë ata për vitin 2023.

z.Naim Çunaku, theksoi, se kush e përbën KKSB-në është e përcaktuar ligjërisht dhe nuk kemi dilema sa i përket kësaj çështje, pra si dhe kur është formuar KKSB nuk kemi dilema sepse ky Kuvend e ka themeluar, mirëpo krejt ajo që patëm në temë ishte se plani i punës së vitit të kaluar të kërkojmë të njoftohemi sa përqind është realizuar. Ky plan që na është sjellë tani a është vetëm një kopje vazhdimësi, pa u realizuar kurgjo nga ai i kaluari. Sa i përket asaj që drejtorët e përbëjnë atë Këshill, konkretisht disa drejtor të Drejtorive të caktuara e që njëri prej tyre është edhe z.Avni Fetahu që është prezent këtu tani, ne i dimë ato dhe nuk kemi nevojë t'i potencojmë ato, mirëpo ajo fjalia që kolegu z.Haki Rudari e ceku më herët, e din drejtori kur e sjellë raportin financiar, drejtori e din, unë them se jo nuk është ashtu sepse përderisa na raportohet neve duhet ta dimë edhe ne ngase drejtori nuk e ka në vullnet të vetin se kur ta sjellë raportin financiar, por është Ligji për menaxhimin e financave publike i cili detyron që deri në një datë të caktuar që duhet të sjellët në Kuvend, jo kur të dëshiron ai. Pra edhe njëherë po e potencoj se nuk jemi pleqëri por jemi shoqëri që na obligojnë normat dhe ligjet dhe ato duhet t'i aplikojmë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, prezent tani në mbledhje e kemi drejtorin e Drejtorisë së Arsimit i cili nëse dëshiron mund të marr fjalën rreth kësaj pike të rendit të ditës.

z.Avni Fetahu, drejtor i Drejtorisë së Arsimit-DKA, theksoi, unë jam anëtar i KKSB kurse koordinator i KKSB është drejtori i DSHPMSh z.Bahri Selimi e që ndoshta do të kishte qenë mirë të ishte prezent këtu dhe ta prezantonte më detajisht. Ka qenë fat i mirë që ky plan është hartuar me Shoqërinë Civile dhe i cili sigurisht e keni parë se është paksa më i avancuar se herëve tjera, ndërsa krejt çka duhet tani është që të

zbatohet për atë për çka jemi dakorduar si Grup punues që të jetë i hapur dhe transparent qoftë për anëtarët e Kuvendit qoftë për qytetarët në përgjithësi.

z.Naim Çunaku, theksoi, dëgjova nga drejtori parafolës që e përmendi fjalën koordinator, dhe kërkoj nga ai të ma gjen ndokund që KKSBB ka koordinator. Pastaj u përmend edhe Shoqëria Civile e që njëri prej anëtarëve është nga Shoqëria Civile, vetëm njëri nga ata dhe nuk jam duke akuzuar apo duke kontestuar unë pse është vetëm një, mirëpo të referohet e gjithë Shoqëria Civile nuk është ashtu, mandej kemi Komandantin e Stacionit të Policisë etj etj, prandaj të mos vnohet poenta vetëm tek një anëtar që është nga Shoqëria Civile.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e vë në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për mbledhjen e radhës.

Me 5 vota PËR, (të tjerët nuk morën pjesë në votim), i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim.

7. Kërkesë nga Qendra Gjenocidi në Kosovë – Plagë e Hapur për përkrahje që Lulëkuqja me katër petale të bëhet simbol përkujtimor i gjenocidit serb në Republikën e Kosovës.

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, duke e paraqitur këtë pikë të rendit të ditës, theksoi, është nga një Organizatë “Plaga e Hapur” për përkrahje që Lulëkuqja me katër petale të bëhet simbol përkujtimorë i gjenocidit serb në Republikën e Kosovës. Pra kemi një kërkesë nga kjo Organizatë që edhe ne si Kuvend i Komunës ta përkrahim që të jetë simbol përkatës një Lulëkuqe me katër petale, e cila brenda përbrenda ku duken farat paraqet njerëzit e moshave dhe gjinive të ndryshme, kështu që unë mënoj se është mirë që kjo të jetë një simbol i gjenocidit serb që është ushtruar në Kosovë, katër petalet paraqesin, njëra fletë vrasjen e Shqiptarëve, tjetra paraqet dhunimet, pastaj shkatërrimet dhe shpërnguljet e Shqiptarëve, kështu që të gjitha këto kanë ndodh me dhunë, andaj është mirë që edhe ne si Kuvend ta përkrahim këtë që të jetë simbol i gjenocidit në Kosovë.

Kjo kërkesë është bërë para rreth 2-3 muajve, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo e hedhim në votim.

Njëzëri, me 9 vota PËR, i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim Kërkesa nga Qendra Gjenocidi në Kosovë – Plagë e Hapur për përkrahje që Lulëkuqja me katër petale të bëhet simbol përkujtimor i gjenocidit serb në Republikën e Kosovës.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 14:20

**Procesverbalin e mbajti;
Osman Bajrami**

**Nr.prot.01-060/04-0025324/23
Podujevë,
06 prill 2023**

**Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit
Hilmi Hoxha**